

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERSITET "HAXHI ZEKA" PEJË	
FAKULTETI I BIZNESIT			
Nr. / Sr. / No. <u>3295</u>		Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>4</u>	
Data / Datum / Date: <u>11-09-2018</u>		Pejë / Pod	

Duke ditur se arsimit dhe edukimi janë elemente bazë të funksionimit të shoqërisë, të vetëdijshëm për përgjegjësinë që kemi para shoqërisë në përgjithësi dhe gjeneratave të ardhshme dhe me qëllim të thellimit të bashkëpunimit ndërmjet komunitetit të biznesit dhe institucioneve të Arsimit të Lartë, me datë 12.06.2018 lidhet kjo:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet:

1. Universiteti Publik "HAXHI ZEKA" në Pejë, të cilën e përfaqëson Prof. Dr. Halit Shabani, Dekan i Fakultetit të Biznesit, në njërën anë dhe
2. Shoqata e Sigurimeve të Kosovës, me numër fiskal 600277067, adresë Rr. Nënë Tereza nr. 34/3 në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Sami Mazreku, Drejtor Ekzekutiv, në anën tjetër.

Neni 1: Lënda e marrëveshjes

- 1.1. Lëndë e kësaj marrëveshje është bashkëpunimi profesional në fushën e sigurimeve. Palët në marrëveshje mund të themelojnë bashkëpunimin në organizimin e trajnimeve profesionale për sigurimet si:
- a. bazat e sigurimeve, menaxhimin e riskut, analizën e riskut, produktet e sigurimeve jetë dhe jo-jetë, risigurimet, marketingu, kanalet e shitjes;
 - b. ligjerimi i përbashkët në trajnime për ndërmjetësues në sigurime dhe trajnimet tjera profesionale;

Neni 2: Organizimi i tryezave të rrumbullakëta

- 2.1. Palët në marrëveshje pajtohen që të organizojnë tryeza të përbashkëta debatuese dhe shkencore, si:
- a. Diskutimet mbi zhvillimin e tregut financiar të sigurimeve;
 - b. Panelist nga industria e sigurimeve si: përfaqësues të shoqatës, anëtarëve të shoqatës, Universitetit Publik "Haxhi Zeka", Banka Qendrore e Kosovës dhe Ministria e Financave;
- 2.2. Organizimi i konferencës vjetore për sigurimet
- a. Analiza e tregut të sigurimeve dhe impakti në ekonomi;
 - b. Trendet në sigurime – zhvillimi i sistemeve dhe produkteve;
 - c. Marketing;

Neni 3: Literatura për sigurimet

3.1. Palët dakordohen që të bashkëpunojnë në shkëmbimin e literaturës në fushën e sigurimeve, si:

- d. Shkëmbimi i literaturës profesionale për sigurimet (librat e botuar, publikimet-revistat, praktikat e mira);
- e. Përmirësimi i buletinit të shoqatës me tema aktuale të zhvillimit të sigurimeve në Europë;
- f. Ofrimi i materialeve profesionale për studentë dhe stafin e kompanive të sigurimit;

Neni 4: Praktika profesionale dhe ligjerata të përbashkëta

4.1. Palët pajtohen të mundësojnë kryerjen e praktikës profesionale të studentëve si:

- a. Bashkëpunimi në përbushjen e programeve akademike për studentë me kryerjen e punës praktike pranë kompanive të sigurimit anëtarë të shoqatës;
- b. Strukturimi i funksionimit të programit të praktikës (caktimi i numrit të studentëve, periudha, etj);
- c. Pajisja me çertifikatë për kryerjen e punës praktike për periudhën përkatëse;

4.2. Ligjeratat e përbashkëta për studentë

- d. Njoftimi mbi aspektin praktik të sigurimeve, për kontratat e sigurimeve vullnetare (shëndet, jetë, pronë, pasuri) – marrjen në sigurim, vlerësimi i riskut, etj.;
- e. Trajtimi i dëmeve në sigurime.

Neni 5: Trajnimet për ndërmjetësues në sigurime

5.1. Palët pajtohen të organizojnë mbajtjen e trajnimeve dhe tryezave për ndërmjetësues në sigurime.

5.2. Nëse Shoqata organizon trajnime të tilla, do të shfrytëzojë sallat e Universitetit Publik “Haxhi Zeka” në Pejë. Orari dhe salla përkatëse e organizimit të trajnimeve do të caktohet me marrëveshje me Dekanin e Universitetit.

Neni 6: Të drejtat dhe detyrimet e palëve

6.1. Palët në marrëveshje marrin përgjegjësi për zbatimin e plotë të kësaj marrëveshje të bashkëpunimit.

6.2. Palët në marrëveshje pajtohen që gjatë implementimit të kësaj marrëveshje të mos çënojnë veprimtarinë e njëra-tjetrës.

Neni 7: Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje

7.1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nënshkruhet për afat të pacaktuar, dhe do të jetë në fuqi derisa palët të njoftojnë njëra tjetren për ndërprerjen.

7.2. Secila palë ka të drejtë të kërkojë ndërprerjen e bashkëpunimit njëanshëm me njoftim paraprak prej 6 muajsh.

Neni 8: Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët janë pajtuar që mosmarrëveshjet eventuale ti zgjidhin me mirëkuptim përmes bisedimeve, e kur kjo nuk është e mundur, çështja mund ti adresohet Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Neni 9: Nënshkrimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje përmban gjithsejt 9 nene, dhe u nënshkrua me datë 12.06.2018 nga palët kontraktuese në 4 kopje identike, nga 2 kopje për secilën palë.

Nënshkruesit e marrëveshjes

z. Halit SHABANI



Dekan i Fakultetit të Biznesit

Universiteti Publik "Haxhi Zeka" në Pejë



z. Sami MAZREKU



Drejtor Ekzekutiv

Shoqata e Sigurimeve të Kosovës

